



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:280732

Datë: 12.04.2024

Numri i dokumentit: 05568208

**P.nr.07/2024**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin Xhemajl JUSUFI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në çështjen penale kundër të pandehurit N.M., për shkak të veprës penale: Dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3 të Kodit 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2141/2023 të datës 12.01.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 02.04.2024 në prezencë të Prokurorit të Shtetit Albana Parduzi, i pandehuri N.M., mbrojtësi i tij sipas autorizimit me shkrim, avokat Milos Delevic, e dëmtuara S.M. dhe mbrojtësi i viktimave Muhamet Pervetica, me datë 04.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 12.04.2024 përpiloi këtë:

#### A K T G J Y K I M

I pandehuri:

N.M., nga i ati D..., e ëma J..., i lindur me datë ..., në Mitrovicë, me vendbanim në Rr. "...., Mitrovicë-Veri, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i tre (3) fëmijëve, punëtorë teknik në shkollën fillore "S.S", i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ....., serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

#### ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datën 14.12.2023 rreth orës 02:20 minuta, në Mitrovicë Veri rruga "L.R", në banesën e përbashkët në gjendje të dehur dhe atë 0.77 promil, duke e sjellë vetën në gjendje të tillë, ushtron dhunë psikologjike me qëllim të cenimit të dinjitetit të të dëmtuarës – viktimë e ndjeshme S.M., si pasojë e mosmarrëveshjeve të vazhdueshme rreth faktit se i pandehuri nuk i lejon të takon vajzën e saj nga martesë e parë, veprime këto të cilat tek e njëjta kanë shkaktuar gjendje të rëndë psikike, ashtu që e njëjta duke u gjendur në një situatë të tillë emocionale, për një moment kishte dalur në ballkon duke kërkuar kështu ndihmë nga qytetarët të cilët pastaj kanë njoftuar policinë.

**Me këtë ka kryer veprën penale: Dhuna në Familje nga neni 248 paragrafi 3 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 17, 20, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 248 të KPRK-së, dhe neneve 242, 364, 449, 450, 452 dhe 460 të KPP-së, të akuzuarin e:

#### G J Y K O N

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 300 euro (*me fjalë: treqind euro*), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë të papaguar.
- II. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale në periudhën e verifikimit prej një (1) viti nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi. Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 14.12.2023 deri me datë 12.01.2024, do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar në rast të revokimit të dënimit me kusht.
- III. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëzetë euro (20) si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- IV. Pala e dëmtuar S.M., ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.2141/2023 të datës 12.01.2024 kundër të pandehurit N.M., për shkak të veprës penale: Dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 02.04.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Albana Parduza, i pandehuri N.M., e dëmtuara S.M. dhe mbrojtësi i viktimave Muhamet Pervetica.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ndjen veten fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, se e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: konsideron se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa lidhur me sanksionin penal, gjykatës i ka propozuar të marrë parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë dhe deklarimin e të dëmtuarës se më të pandehurin i kanë përmirësuar raportet si dhe rrethana rënduese ato siç janë paraqitur në pikën IV të propozimeve në Aktakuzë.

Mbrojtësi i të pandehurit N.M., avokat Milos Delevic lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ka deklaruar: se i propozon gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë i cili është bërë në mënyrë vullnetare ndërsa lidhur me sanksionin penal ka kërkuar nga gjykata se me rastin e caktimit dhe llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethanë lehtësuese të merr parasysh se është hera e parë që i pandehuri është ra desh me ligjin, nuk ka pas dhunë fizike, vetëm një dhunë psikologjike pra ka qenë një mosmarrëveshje e momentit rreth fëmijës së vogël nga një martesë e përparme, i cili duhet të

kaloj kufirin dhe të vijë në familjen e të pandehurit dhe e ka lutur gjykatën të merr parasysh se meqenëse kjo veprë penale parashihet dënim me gjobë dhe burgim, konsideron se koha e kaluar në masën e paraburgimit është një dënim i mjaftueshëm për veprën penale dhe sa i përket dënimit me gjobë të ketë parasysh se i pandehuri është mbajtur në familjes dhe i gjendjes së dobët ekonomike.

E dëmtuara në shqyrtim fillestar dhe lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ka deklaruar: se e mbështet pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, nuk parashtron kërkesë pasurore juridike dhe me të pandehurin jetojnë bashkë dhe nuk kanë pasur më problem.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të njëjtin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2023-SA-278 i datës 14.12.2023; Raporti i oficerit i datës 14.12.2023; Raporti i shpejtë, i datës 14.12.2023; Procesverbali mbi marrjen në pyetje i të dëmtuarës S.M., i datës 14.12.2023; Raporti Emergjent, i datës 14.12.2023; Raporti mjekësor në emër të dëmtuarës S.M., i datës 14.12.2023; Procesverbal mbi marrjen në pyetje i të pandehurit N.M. të dhënë në hetuesi, me datë 14.12.2023; Procesverbali mbi marrjen në pyetje dëshmitarin T.G., i datës 14.12.2023; Procesverbali mbi marrjen në pyetje dëshmitarin H.D., i datës 14.12.2023; Procesverbal mbi marrjen në pyetje i të pandehurit N.M. të dhënë në Prokurori, me datë 09.01.2023; Procesverbal mbi marrjen në pyetje i të dëmtuarës S.M. të dhënë në Prokurori, me datë 11.01.2023; Alkool testi; si dhe shkresat tjera të lëndës.

Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimi të fajësisë, vërtetohet përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, dhe se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimi të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri, me veprimet e tij, ka kryer veprën penale: Dhuna në familje nga neni 248 paragrafi 3 të KPRK-së, e për të cilën veprë penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tri (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-së. Rrethana rënduese lidhur më këtë rast, gjykata vlerëson faktin se veprat e tilla penale, janë gjithnjë e më të shpeshta në vendin tonë, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë, si dhe duke marrë parasysh keqardhjen e shprehur nga i pandehuri në seancë gjyqësore, gjithashtu rrethanë tjetër lehtësuese gjykata mori rrethanat e tij personale, se i njëjti është person familjar, baba i tre fëmijëve, kërkim faljen e shprehur në gjykatë

ndaj të dëmtuarës për rastin që ka ndodhur, si dhe premtimin gjykatës se nuk do të përsërisë veprime të tilla dhe gjithashtu sepse për të pandehurin, nuk ka të dhëna se i njëjti ka qenë më parë i dënuar për ndonjë/çfarëdo veprë tjetër penale.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me gjobë dhe me burgim me kusht ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, e dëmtuara, në seancën e shqyrtimit fillestar, ka hequr dorë nga parashtrimi i kësaj kërkesë.

Andaj gjykata, duke u bazuar në nenin 242, 364, 449, 450,452 dhe 460 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.07/2024, datë 12.04.2024**

Zyrtarja ligjore  
Doruntina BEKA

Gjyqtari  
Xhemajl JUSUFI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.